



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 5317/4/prot.

Laç, më 01.12.2023

VENDIM

Nr. 30, datë 23/11.2023

“PËR MIRATIMIN E LISTES SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA”.

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të ligjit nr.97/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 40, datë 31.01.2020 “Për miratimin e platformës online të aplikimit për programet e rindërtimit dhe manualin e përdorimit të platformës, si dhe manualin e procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, të ndryshuar, të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.18 datë 15.05.2020, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 25.03.2021 “Për miratimin e Rindërtimit të njësisë të banimit në ndërtesa (pallat) të vlerësuara për shembje (të shembur nga ana jonë) sipas akt ekspertizave të thëlluara të kyera nga Instituti i Ndërtimit” si dhe të shkresës nr.5317/1 prot, datë 15.11.2023 “Raport i plotë me propozimin për subjektet pas plotësimit të dosjeve me dokumentacion që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit, programi i zhvillimit të objekteve të reja”, të hartuar nga Komisioni i Posaçëm, pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë ,Këshilli Bashkiak :

VENDOSI :

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit, programi i zhvillimit të objekteve të reja, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Shërbimeve Publike të njoftojë familjet që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit, programi i zhvillimit të objekteve të reja brenda 5 ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga Këshilli Bashkiak.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise.

Ky vendim hyn ne fuqi 10 (dhjete) dite pas shpalljes

- > Prefektit Qarkut Lezhe
- > Drejtoria e Shërbimeve Publike
- > Drejtoria e Finances
- > Arkivi

SEKRETAR I KESHILLIT
Arber LEKA



KRYETARE E KESHILLIT
Edlira LLESHI

